

NISHOVA ENERGY SH.P.K.

PASQYRAT FINANCIARE

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

Përmbajtja

Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Performancës & e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto	3
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare	4
Shënime Shpjeguese	5


PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR INDRYSHE)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
AKTIVET			
I. Aktivet Afatshkurtra			
Mjete monetare	4	5,470,934	2,284,175
Të drejta të arkëtueshme	5	442,947	21
Të tjera të drejta të arkëtueshme	6	21,152,972	22,517,974
Të tjera të drejta afatshkurtra	7	2,676,758	3,527,637
Totali i aktiveve afatshkurtra		29,743,611	28,329,807
II. Aktivet afatgjata			
Aktive materiale	8	3,747,530	4,123,252
Aktive jo-materiale	9	188,688,596	197,782,011
Totali i aktiveve afatgjata		192,436,126	201,905,263
TOTALI I AKTIVEVE		222,179,737	230,235,070
DETYRIMET			
I. Detyrimet afatshkurtra			
Detyrime tregtare	10	2,697,776	3,944,161
Të pagueshme ndaj punonjësve	11	3,441,739	3,181,750
Të pagueshme për detyrime tatimore	12	64,919	50,105
Totali i detyrimeve afatshkurtra		6,204,434	7,176,016
II. Detyrime afatgjata			
Detyrime financiare	13	250,677,626	250,674,217
Totali i detyrimeve afatgjata		250,677,626	250,674,217
Totali i Detyrimeve		256,882,060	257,850,233
III. Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nënshkruar	14	4,679,086	4,679,086
Humbja e mbartur	14	(32,294,251)	(22,204,668)
Fitim (humbja) e vitit	14	(7,087,158)	(10,089,581)
Totali i Kapitalit		(34,702,323)	(27,615,163)
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		222,179,737	230,235,070

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan nga NISHOVA - ENERGY Sh.p.k dhe u nënshkruan si më poshtë:


Isidoro Rebato
Përfaqësues ligjor

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHË)

Pasqyra e Performancës & e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	7,454,445	7,586,362
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		2,195,028	441,468
Shpenzime të personelit	16		
1. Paga dhe shpërblime		(1,692,198)	(2,073,174)
2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(305,969)	(346,228)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	17	(9,469,137)	(9,417,511)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	18	(5,147,139)	(6,136,897)
Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		(6,964,970)	(9,945,980)
Të ardhura të tjera			
1. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
2. Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata			
3. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme			
Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra			
Shpenzime financiare	19		
1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme			
2. Shpenzime të tjera financiare		(122,188)	(143,601)
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi (humbja) para tatimit		(7,087,158)	(10,089,581)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	20		
1. Shpenzimi i tatimit fitimit të periudhës			
2. Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë			
3. Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve			
Fitimi (humbja) neto e vitit		(7,087,158)	(10,089,581)
Te ardhura te tjera gjithepershiresë per vitin			
Diferencat (+/-) nga perktimi i monedhes ne veprimtari te huaj			
Diferencat (+/-) nga rivlersimi i aktiveve afatgjata materiale			
Diferencat (+/-) nga rivlersimi i aktiveve financiare te mbartura per shitje			
Pjesa e te ardhurave gjithepershiresë nga pjesemarrjet			
Totali i te ardhurave te tjera gjithepershiresë per vitin			
Totali i te Ardhurave Gjithëpërfshirëse per vitin		(7,087,158)	(10,089,581)

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHË)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e Vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	4,679,086						(25,320,585)	3,115,916	(17,525,583)
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël									-
Pozicioni financiar i deklaruar më 1 janar 2019	4,679,086						(22,204,669)		(17,525,583)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									
Fitimi / Humbja e vitit								(10,089,581)	(10,089,581)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse:									
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									
Dividendë të paguar									
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									
Pozicioni financiar i deklaruar më 31 dhjetor 2019	4,679,086						(22,204,669)	(10,089,581)	(27,615,164)
Pozicioni financiar i deklaruar më 1 janar 2020	4,679,086						(32,294,250)		(27,615,164)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									
Fitimi / Humbja e vitit								(7,087,158)	(7,087,158)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:									
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									
Dividendë të paguar									
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									
Pozicioni financiar i deklaruar më 31 dhjetor 2020	4,679,086						(32,294,251)	(7,087,158)	(34,702,323)

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHË)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
I. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit		
Fitim/ Humbja e periudhes	(7,087,158)	(10,089,581)
Rregullime per shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet per tatimin mbi fitimin jomonetar	-	
Shpenzime konsumi & amortizimi	9,469,137	9,417,511
Zhvleresimi I aktiveve afatgjata materiale		
Fluksi I mjeteve monetare I perfshire ne aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshime ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit:		
Renie / (rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	1,772,951	528,398
Renie / (rritje) ne inventare	-	
Rritje / (renie) ne detyrimet e pagueshme	(1,246,383)	634,377
Rritje / (renie) ne detyrimet per punonjesit	259,989	315,588
Rritje / (renie) ne detyrimet e tjera	14,814	(55,355)
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	3,183,350	750,938
II. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit		
a. Para te perdorura per blerjen e filialeve (shuma neto)		
b. Para te arketuara nga shitja e filialeve (shuma neto)		
c. Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(653,648)
d. Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
e. Pagesa per blerjen e investimeve te tjera		
f. Arketime nga shitja e investimeve te tjera		
g. Dividende te arketuar		
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit	-	(653,648)
III. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit		
a. Arketime nga emetimi I kapitalit		
b. Arketime nga emetimi I aksioneve te perdorura si kolateral		
c. Hua te arketuara	3,409	
d. Pagesa e kostove te transaksionit qe lidhen me kredite dhe huate		
e. Riblereje e aksioneve te veta		
f. Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral		
g. Pagesa e huave		
h. Pagesa e detyrimeve te qirase financiare		
i. interes I paguar		
j. Dividende te paguar		
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit	3,409	-
IV. Rritja/(pakesimi) neto i mjeteve monetare	3,186,759	97,290
V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes	2,284,175	2,186,885
VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes	5,470,934	2,284,175

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Shënimet Shpjeguese

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

NISHOVA - ENERGY Sh.p.k (në vijim referuar si "Shoqëria") është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 31.10.2009 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëria është e regjistruar në Degën e Tatimeve dhe Taksave Tiranë me NIPT/NUIS K99631401M. Shoqëria zhvillon aktivitet në fushën e ndertimit, operimit dhe transferimit të hidrocentraleve Nishova 1 dhe Nishova 2 tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndertimi, venia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike, në zbatim të Kontrates së Koncesionit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

Kapitali aksionar fillestar i shoqërisë është 4,700,000 Lekë, i cili zotërohet si më poshtë vijon:

Ortaku: FIDALCO Pjesa e zotëruar 50%;

Ortaku: GEO ENERGY Pjesa e zotëruar 50%.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është Z. Isidoro Rebato.

Adresa e shoqërisë është: Rruga Themistokli Gërmenji, pallati Ambasador 1, kati I, Tiranë.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është 3 punonjës.

2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) në Shqipëri. Drejtimi i shoqërisë vlerëson se shoqëria do të vijojë aktivitetin normal tregtar për 12 muajt që pasojnë muajin e mbylljes së këtyre pasqyrave financiare. Për rrjedhojë, pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2020 janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë. Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", paragrafi 4, Shoqëria ka vendosur të mos njohë tatimet e shtyra në pasqyrat e saj financiare.

2.2 BAZAT E MATJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 MONEDHA FUNKSIONALE DHE E PARAQITJES

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, monedha funksionale e Shoqërisë.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

2.4 VLERËSIME DHE GJYKIME

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysht thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga shoqëria.

3 POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të meposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare

3.1 TRANSAKSIONET NË MONEDHË TË HUAJ

Transaksionet në monedhe të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhe të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit, të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është percaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi i këmbimit me 31 Dhjetor 2020 leke/ euro është 123.70.

3.2 INSTRUMENTAT FINANCIAR

Instrumentat financiare jo-derivative përbëhen nga llogari të arketueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa përshkruhet me poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHË)

fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në vijim të njohjes fillestare.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parase së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyres së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar; mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivitetit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, e kërkesave për t'u arkëtuar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHË)

3.3 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

(i) *Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhylerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kane jetë gjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të hesueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit duke filluar nga dita e pare e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirase dhe jetë së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 ZHVLERËSIMI

(i) *Aktivët financiarë*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivët financiarë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me parë në kapital, transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërise, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 PROVIZIONET

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parase me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parase dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 NJOHJA E TË ARDHURAVE

Të ardhurat njihen në pasqyrën e performancës në përputhje me SKK 8 Të ardhurat. Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmëri, të ardhurat e lidhura me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;
- Volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;
- Shpenzimet e bëra për shërbimin, si dhe ato që do të bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NJUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

3.7 TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nepermjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për tu paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% e fitimit të tatueshëm.

3.9 KRAHASUESHMËRIA

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

4. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTËT E TYRE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Mjete monetare EUR	82,346	60,440
Mjete monetare ALL	5,388,588	2,223,735
Total	5,470,934	2,284,175

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Të drejta të arkëtueshme	442,947	21
Total	442,947	21

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

6. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
TVSH e arkëtueshme	21,152,972	22,517,974
Total	21,152,972	22,517,974

7. TË TJERA TË DREJTA AFATSHKURTRA

Të tjera të drejta afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Parapagime të dhëna	2,465,662	2,465,662
Të ardhura të llogaritura	-	870,348
Shpenzime të shtyra dhe të tjera	211,096	191,627
Total	2,676,758	3,527,637

8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjatë të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Totali	Toka	Instalime teknike, makineri, pajisje etj	Mjete transporti
Me 31 Dhjetor 2018	5,237,960	2,244,640	60,008	2,933,312
Shtesa	653,646	-	653,646	-
Me 31 Dhjetor 2019	5,891,606	2,244,640	713,654	2,933,312
Shtesa	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2020	5,891,606	2,244,640	713,654	2,933,312
Amortizim i Akumuluar				
Me 31 Dhjetor 2018	(1,444,258)		(12,802)	(1,431,456)
Shtesa	(324,096)		(23,725)	(300,371)
Pakesime 2019	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	(1,768,354)		(36,527)	(1,731,827)
Shtesa	(375,722)		(135,425)	(240,297)
Pakesime 2020	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2020	(2,144,076)		(171,952)	(1,972,124)
Vlera Kontabel Neto				
Me 31 Dhjetor 2018	3,793,702	2,244,640	47,206	1,501,856
Me 31 Dhjetor 2019	4,123,252	2,244,640	677,127	1,201,485
Me 31 Dhjetor 2020	3,747,530	2,244,640	541,702	961,188

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHË)

9. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivët afatgjatë jomateriale të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Totali	Koncesione dhe të drejta të ngjashme, liçensa të ngjashme
Me 31 Dhjetor 2018	233,397,886	233,397,886
Shtesa	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	233,397,886	233,397,886
Shtesa	-	-
Me 31 Dhjetor 2020	233,397,886	233,397,886
Amortizim i Akumuluar		
Me 31 Dhjetor 2018	(26,522,460)	(26,522,460)
Shtesa	(9,093,415)	(9,093,415)
Pakesime 2019	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	(35,615,875)	(35,615,875)
Shtesa	(9,093,415)	(9,093,415)
Pakesime 2020	-	-
Me 31 Dhjetor 2020	(44,709,290)	(44,709,290)
Vlera Kontabel Neto		
Me 31 Dhjetor 2018	206,875,426	206,875,426
Me 31 Dhjetor 2019	197,782,011	197,782,011
Me 31 Dhjetor 2020	188,688,596	188,688,596

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

10. DETYRIME TREGTARE

Detyrimet tregtare më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	2,697,776	3,944,161
Total	2,697,776	3,944,161

11. TË PAGUESHME NDAJ PUNONJËSVE

Të pagueshme ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Të pagueshme ndaj punonjësve	3,441,739	3,181,750
Total	3,441,739	3,181,750

12. TË PAGUESHME PËR DETYRIME TATIMORE

Të pagueshme për detyrime tatimore më 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Detyrim për Sigurimet Shoqërore & Shëndetsore	35,133	44,918
Detyrim për Tatimin mbi të Ardhurat	4,719	5,187
Detyrim për Tatimin në burim	25,067	-
Total	64,919	50,105

13. DETYRIME AFATGJATA

Detyrimet afatgjata më 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Hua me pale të lidhura	250,677,626	250,674,217
Total	250,677,626	250,674,217

14. KAPITALI I VET

Kapitali i vet më 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Kapitali i Nënshkruar	4,679,086	4,679,086
Fitimi / Humbja e mbartur	(32,294,251)	(22,204,668)
Fitim (humbja) e vitit	(7,087,158)	(10,089,581)
Totali i Kapitalit	(34,702,323)	(27,615,163)

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

15. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Të ardhura nga shitje energjie	7,454,445	7,586,362
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	2,195,028	441,468
Total	9,649,473	8,027,830

16. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime të personelit më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Pagat	(1,692,198)	(2,073,174)
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	(305,969)	(346,228)
Total	(1,998,167)	(2,419,402)

17. AMORTIZIMI

Amortizimi më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Amortizimi aktivet afatgjata	(9,469,137)	(9,093,415)
Aktivt afatgjata jomateriale	-	(324,096)
Total	(9,469,137)	(9,417,511)

18. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzimet e tjera më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Mirëmbajtje dhe riparime	(1,621,138)	(4,199,420)
Sherbim konsulence financiare, ligjore, teknike	(593,440)	(602,084)
Shpenzime komunikimi	(228,224)	(19,003)
Taksa lokale	(524,772)	(624,773)
Gjoha dhe penalitete	(195,293)	(3,016)
Shpenzime te tjera	(1,984,272)	(688,601)
Total	(5,147,139)	(6,136,897)

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

19. TË ARDHURA FINANCIARE – NETO

Të ardhurat neto financiare më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Te ardhura financiare:		
Të ardhura nga interesat	-	-
Të ardhura të përealizuara nga kembimet	10,164	44,791
Të ardhura të realizuara nga kembimet	673	48
	10,837	44,839
Shpenzime financiare:		
Komisione bankare	(49,575)	(93,911)
Humbje të përealizuara nga kembimet	(83,399)	(90,898)
Humbje të realizuara nga kembimet	(51)	(3,631)
	(133,025)	(188,440)
Total	(122,188)	(143,601)

20. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Rezultati kontabël i shoqërisë është humbje në vlerën 7,087,157 Lekë, ndërkohë shpenzimet e panjohura janë 1,338,249 lekë dhe rezultati fiskal është humbje në vlerën 5,748,908 lekë. Tatimi mbi fitim rezulton 0 lekë ndërkohë që Shoqëria nuk ka kryer parapagime.

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Fitimi(Humbja) Kontabel	(7,087,157)	(10,089,579)
Shpenzime te panjohura sipas ligjit fiskal		
Shpenzime te tjera	-	-
Gjoha dhe penalitete	1,338,249	3,016
Shpenzime te pritjes e perfaqesimit	-	-
Totali i shpenzimeve te panjohura	1,338,249	3,016
Fitimi i tatueshem	(5,748,908)	(10,086,563)
Humbje e mbartur		
Tatimi mbi fitimin @ 15%	-	-
Parapagime gjate vitit	-	-
Tatim fitimi	-	-

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2020

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për biznesin e madh për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020.

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

19. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime të ndryshme nga të tretë dhe masa ligjore. Vecanërisht, legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose që konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të periudhës raportuese, është objekt i interpretimeve të ndryshme përse i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor ndërmarrë nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Nën rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Me 31 dhjetor 2020, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale apo operationale të kontraktuara por ende të papaguara.

20. NGJARJE TË MËPASSHME

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.